




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY



DATË/A:	10.07.2018
REFERENC-Ë:	AKK- DPKPP /03-03-1848/18
PËR/ZA/TO:	z. Artan FEJZA, UD. Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit në Ministrinë e Shëndetësisë
CC:	z. Naim BARDIQLI, UD. Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë
NGA/OD/FROM:	Shaip HAVOLLI, Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull " Shërbime inxhinerike për Spitalin e Prizrenit, detyrat projektuese, projekti ideor dhe projekti kryesor "

I nderuari z. FEJZA ,

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 9 (par. 1, nënpar. 1.5.), 16 (par. 2) dhe 21 (par. 3) të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2017 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 01/2014, së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me tenderin me titull " **Shërbime inxhinerike për Spitalin e Prizrenit, detyrat projektuese, projekti ideor dhe projekti kryesor** ", me nr. të prokurimit: 206-18-4452-221, dhe me nr. të brendshëm: 206-018-068-221, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin " **Shërbime inxhinerike për Spitalin e Prizrenit, detyrat projektuese, projekti ideor dhe projekti kryesor** ", me nr. të prokurimit: 206-18-4452-221, dhe me nr. të brendshëm: 206-018-068-221, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për prokurimin publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L - 237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092.

Arsy etimi

Agjencia Kundër Korrupsionit (në tekstin e mëtejme Agjencia), duke vepruar sipas detyrës zyrtare pas kontrollimit të njoftimeve për kontratë që ka bërë në Sistemin elektronik të Prokurimit, me datë 09.07.2018, ka nxjerrë vendim me numër protokolli: *AKK-03-03-1848/18*, për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit publik me titull "**Shërbime inxhinerike për Spitalin e Prizrenit, detyrat projektuese, projekti ideor dhe projekti kryesor**", me nr. të prokurimit: **206-18-4452-221**, dhe me nr. të brendshëm: **206-018-068-221**, i iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Ministria e Shëndetësisë.

Agjencia në bazë të dokumenteve të nxjerra nga Sistemi elektronik i Prokurimit ka analizuar njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, ku ka konstatuar se Autoriteti Kontraktues, për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë procedurë të hapur, kontratë publike të llojit shërbime, me vlerë të mesme prej 33.000.00 €.

Agjencia, pasi ka analizuar me kujdes njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit ka vërejtur se tek rubrika *III.2.4. Kapaciteti teknik dhe profesional kërkesa 1*, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar nga Operatorët Ekonomik të dëshmojnë se kanë përfunduar gjatë tri viteve të fundit **minimum dy kontrata për projektim të natyrës së njëjtë - objekte shëndetësore, deri në njoftimin për kontratë, ku vlera e kontratave duhet të jetë minimum 49.000,00 €**. Ndërsa tek dëshmia e kërkuar dokumentare pika 1 është kërkuar Lista e projekteve origjinale e nënshkruar dhe e vulosur, referencat në projektim të natyrës së njëjtë – objekte shëndetësore në tri vitet e fundit, llogaritet nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, ku tek lista e kontratave ndër të tjera është janë kërkuar referenca nga Autoriteti Kontraktues kopje e noterizuar. **Kërkesë kjo për të cilën Agjencia konsideron se bien ndesh me nenin 69 të Ligjit në fuqi për Prokurimin Publik.**

Sipas Ligjit në fuqi për Prokurimin Publik më saktësisht në nenin 69 paragrafi 4.2. parashihet se Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë "listën me të cilën saktësohen të gjitha kontratat kryesore të rëndësishme të shërbimeve të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare, duke saktësuar llojin e shërbimeve të përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin; (i) kur shërbimet janë siguruar për autoritetin publik në Kosovë ose në vendin tjetër, si dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve do të shërbejë kopja e certifikatës (certifikatave) përkatëse të lëshuar ose bashkë nënshkrura nga autoriteti i tillë publik; (ii) kur shërbimet janë siguruar për blerësin privat, dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve duhet të jetë kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i sigurimit të tillë.

Pra në këtë rast do duhej të kërkohej lista e kontratave bashkangjitur si dëshmi referencat mbi përfundimin e kontratave në vlerë totale të gjitha referencave të referencave të ngjashme të realizuara në tri vitet e fundit para publikimit të njoftimit për kontratë e jo si në rastin konkret ku është kufizuar numri i projekteve në vlerën e caktuar prej 49.000,00 €.

Agjencia vëren se janë kërkuar referenca nga Autoriteti Kontraktues, kërkesë kjo e cila bie ndesh me Legjislacionin në fuqi për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës.

Bazuar në legjislacionin në fuqi konkretisht nenin 69 Aftësitë Teknike dhe profesionale të Ligjit për Prokurim Publik Nr.04/L-042 , i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe nenin 26 Paragrafi 8 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, Agjencia kundër Korrupsionit konsideron se një Autoritet Kontraktues ka të drejtë që në kuadër të kriterëve të përzgjedhjes të kërkoj si dëshmi kontrata dhe referenca me të cilat do ta vërtetonte kapacitetin teknik dhe profesional të operatorëve ekonomik. Mirëpo, nëse Autoriteti Kontraktues vendos një kërkesë të tillë për ta vërtetuar aftësinë teknike dhe profesionale të operatorëve ekonomik, duhet të ceket *referenca apo certifikata të Autoriteteve Publike dhe Personave Privat*, e jo siç ka vepruar në rastin konkret ku është cekur referenca vetëm nga Autoritetet Kontraktuese.

Agjencia, gjithashtu vëren se referencat janë kërkuar në kopje të noterizuar. Lidhur me këtë kërkesë Agjencia konsideron se është një dokument publik i cili lehtë verifikohet nga ana e Autoritetit Kontraktues, andaj konsiderojmë se kërkesa për noterizim krijon shpenzime të pa nevojshme për Operatorët ekonomik.

Konsiderojmë se veprimet e tilla si në rastin konkret e kufizojnë konkurrencën e lirë dhe diskriminojnë Operatorët ekonomik të cilët mund të bëjnë shërbime të ngjashme, andaj, Autoriteti Kontraktues duhet të këtë kujdes që të caktoj kërkesa minimale të kualifikimit.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues, konsiderojmë se bien ndesh me nenin 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi nenin 27 Dosja e Tenderit dhe nenin 69 Kapaciteti teknik/profesional të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L -237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092 dhe nenin 26 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik.

Konsiderojmë se shkelje të tilla nuk duhet lejuar në aktivitete të prokurimit, andaj Agjencia Kundër Korrupsionit rekomandon që të evitohen këto shkelje, përmes njoftimit standard për informata shtesë dhe për përmirësimin e gabimeve, duke i njoftuar Operatorët të cilët e kanë tërhequr dosjen e këtij tenderi.

Po ashtu ju njoftojmë se lidhur me këto të gjetura do të njoftohet Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik – KRPP.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !